



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 31
Prishtinë, më 11.07.2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

Morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Nezir Çoçaj, Driton Çausi, Arbërie Nagavci, Fidan Rekalju, Valentina Bunjaku – Rexhepi dhe Verica Çeraniq.

Munguan: Abdyl Salihu dhe Albulena Balaj – Halimaj.

Përfaqësues të tjerë: Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë z. Besim Beqaj , KDI, mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Raportim i ministrit të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë z. Besim Beqaj;**
3. **Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Raportim i ministrit të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë z. Besim Beqaj;

Ismajl Kurteshi, kryesues, tha se Komisioni ka vendosur ta ftojë ministrin e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë z. Besim Beqaj me qëllim që të njoftohet për punën e kësaj ministrie të arriturat gjashtëmujore si dhe prioritetet.

Besim Beqaj, ministër i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, në diskutimin e tij para Komisionit foli për punën që ka bërë Ministria që ai e drejton, buxhetin dhe të arriturat tjera.

Ai tha se është themeluar Këshilli Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi, i cili ka për synim që të bëhet koordinimi i aktorëve që kanë të bëjnë me inovacion dhe ndërmarrësi, me qëllim është që ta fusin inovacionin dhe teknologjinë informative në zhvillimin ekonomik.

Më tej përmendi lansimin e programeve dhe mjetet financiare të organizatave joqeveritare që pritet t'iu ndahen për ta zhvilluar inovacionin për start-up.

Beqaj tha, se është hera e parë që Ministria ka bërë marrëveshje për bashkëfinancim me Qeverinë Gjermane përmes GIZ-it, ku është bërë ndarja e 1.2 milion euro për përkrahje të sektorit privat në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë,

Gjithashtu, Beqaj përmendi Vendimin e Qeverisë për bashkëpunim me Qeverinë Gjermane për të ndërtuar parkun gjermano-kosovar në Prizren, ndërsa në Ferizaj 39 hektarë hapësirë do të shndërrohet në park për inovacion dhe ndërmarrësi.

Beqaj tha se nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë është premtuar se do të ndajmë një hapësirë për të bërë një qendër inovative në kuadër të Universitetit të Prishtinës.

Ai tregoi se pritet që edhe në Komunat e tjera, janë në diskutim për të krijuar hapësirë për inovacion si në Mitrovicë dhe në Pejë.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, tha se Kosova duhet të ecë në hap me kohën sa i përket digjitalizimit. Ajo kërkoi informata nga ministri se cilat janë kriteret që një komunë duhet t'i plotësojë për t'u pajisur me një qendër.

Teuta Haxhiu, falënderoi ministrin për raportimin dhe gatishmërinë e tij. Ajo tha se do të dëshironte të ishte pjesë e diskutimit publik sa i përket strategjisë së lartpërmendur. Gjithashtu tha se komisioni nuk është i informuar për formimin e një Këshilli dhe që asnjë anëtarë nuk është pjesë e këtij Këshilli. Në anën tjetër, ajo tha që edhe pse Ministria e Inovacionit ka një ligj të ngjashëm me Ligjin e Komisionit, kjo ministri bart një përgjegjësi karshi këtij ligji dhe do të

dëshironte të dinte se cili do të jetë kontributi i tyre. Haxhiu kërkoi sqarim nga ministri për qendrën në Gjakovë, e cila nuk është rifunksionalizuar asnjëherë dhe për hapat konkret rreth fuqizimit të kësaj qendre. Për fund, ajo tha se çdo kontribut që i atribuohet moshës rinore, është me interes për të gjithë vendin.

Nezir Çoçaj, tha se themelimi i kësaj Ministrie ka qenë shumë shpresëdhënës pasi që praktikat e vendeve tjera tregojnë që sa më herët që Ministria e Inovacionit ka qenë e funksionalizuar, aq më shumë kanë pasur përparime, andaj edhe ne në Kosovë, me një rini entuziaste dhe inteligjente mund të korret po i njëjti sukses. Çoçaj kritikoi ministrin për mosardhjen e tij në thirrjen e komisionit. Ai i tha se duhet të vijë vetë ministrit kur të thirret nga komisioni dhe jo të dërgojë këshilltarë dhe përcjellës të tjerë.

Driton Çausi, nga PSD-ja, falënderoi ministrin për raportin. Ai tha se për nga mënyra e raportimit edhe hezitimet dhe shqetësimet e shoqërisë civile, qytetarëve dhe opozitës marrin kuptim. Ai tha se nuk shpreson shumë që kjo Ministri ka mbushur vërtetë një boshllëk në institucionet e RKS-së, që do të jepte si produkt rritjen e inovacionit ose një ndihmë në fushën e arsimit ose zhvillimit ekonomik sepse nuk janë të planifikuara aktivitetet konkrete as të Këshillit e as të Ministrisë.

Çausi tha se duhet të tregohet arsyeja se pse organizatave joqeveritare po iu ndahet fond më shumë sesa start-up-ve dhe shqetësimi i tij ishte se nuk po tregohet arsyeja se për çfarë më konkretisht janë të ndara këto fonde si dhe nëse Ministria ka një strategji për qëndrueshmërinë e këtyre qendrave.

Ismajl Kurteshi, pyeti ministrin se a nuk kanë pasur mundësi që të bashkëpunojnë me MASHT-in sa i përket hartimit të një ligji që së paku për nga emërtimi është i ngjashëm me ligjin që Komisioni ka pasur, ku sponsor ka qenë MASHT-i. Gjithashtu, ai shprehu shqetësimin e tij mbi terminologjinë angleze të përdorur në ligj, e cila do të mund të zëvendësohej shumë mirë me terma të gjuhës shqipe.

Fidan Rekalii, tha se është një fakt i pamohueshëm që iniciativa e të rinjve tanë ka bërë që ne të jemi në hap me trendët e vendeve tjera, mirëpo, nuk ka hapësirë të mjaftueshme nga institucionet

tona. Ai përgëzoi ministrin për punën e bërë si një shpresë për të rinjtë dhe uroi të mos ketë anime politike.

z. Besim Beqaj, falënderoi deputetët për përkrahjen e ofruar. Ai tha se është bërë ftesë publike për të gjitha komunat në nivel rajoni për partneritet në hapjen e qendrave rajonale. Sa i përket bashkëpunimit të komunave me universitetet publike, ai tha se kudo që komuna bashkë me universitetin konsideron që ka kapacitet të mjaftueshëm, Ministria është e gatshme për të proceduar me qendra sepse këto qendra mund të funksionojnë vetëm aty ku ka ide për tu trajnuar, me shpenzime të mbuluara sepse sipas tij, rinia në Kosovë po vepron shumë më shpejt se sa që po veprojnë institucionet.

Ai tha se ligji për inovacion dhe transfer të dijes nuk përfundon vetëm me punime shkencore të cilat publikohen në një revistë, mirëpo, që funksionon kur rritet kapaciteti i prodhimit, produktivitetit dhe i shërbimeve. Po ashtu, ai tha se me ligj do të rregullohet financimi i novatorëve dhe se do të trajtohen në kontekst ekonomik sepse ndryshe nuk do të kishte vlerë investimi.

Sa i përket financimit të OJQ-ve dhe start-up-ve, ai tha se janë mbi 7 milion në përkrahje të sektorit privat kurse 1.5 milion janë investuar në OJQ, në bashkëpunim me gjermanët.

Në anën tjetër, Beqaj tha se Këshilli është me karakter këshillues dhe nuk është vendimmarrës si dhe që i pranon të gjithë që kanë dëshirë të marrin pjesë dhe të krijojnë opinion me mendimet e tyre. Ky këshill trajton dokumentet që dalin prej ministrisë, por që nuk merr vendim sepse është këshill me qëllime konsulence.

Ismajl Kurteshi, falënderoi ministrin për raportimin në lidhje me punën e Ministrisë, duke i uruar punë të mbarë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Ismajl Kurteshi